



Funded by the E.U



Manifesti i prioriteteve të komuniteteve rurale në Korçë

Ky manifest, i përgatitur nga Këshilli për Zhvillim Rural Korçë, i drejtohet shoqërisë, në veçanti atyre që janë të përfshirë në aktivitete bujqësore, ndërmarrjeve dhe të gjitha institucioneve publike apo private, që:

- Të mbështesin fermerët në përmirësimin e prodhimit bujqësor (rendimentin), e sigurimin e një furnizimi të rregullt dhe të përballueshëm të ushqimit;
- Të mbrojnë fermerët e jetesën e arsyeshme;
- Të ndihmojnë në përballimin e ndryshimeve të klimës, përmirësimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të natyrës;
- Të ruajnë dhe mirëmbajnë hapësirat rurale dhe peizazhet e gjithë vendit;
- Të mbajnë ekonominë rurale të gjallë duke hapur vende pune në bujqësi, agro-ushqim dhe sektorët e tjerë;

Këshilli për Zhvillim Rural Korçë mbështetur nga Projekti “Rural Korçë” i kushton hapësirë qytetarëve dhe komunitetit rural të rajonit të Korçës me qëllim nxitjen e një pjesëmarrjeje aktive të shoqërisë civile rurale dhe mbështetjen e një qeverisjeje të mirë të orientuar nga qytetarët dhe grupet e interesit qofshin ato publike apo private (gra, burra, studentë, banorë të zonave rurale, konsumatorë, shoqata, biznese, universitete, bashki, etj.), duke i përfshirë ata në veprime konkrete në shërbim të zhvillimit territorial.

Ky Manifest përmbledh parimet dhe prioritetet, duke prekur një sërë çështjesh të cilat reflektojnë nevojat dhe qëllimet e rajonit të Korçës. Çështjet e mëposhtme përfaqësojnë prioritetet e komuniteteve rurale që duhet të përmbushen me qëllim nxitjen e një zhvillimi rural të qëndrueshëm, të drejtë dhe inovativ.

- Komuniteti i zonave rurale të marrë pjesë dhe të udhëheqë zhvillimin e shërbimeve jetësore në këto zona;
- Komuniteti dhe Këshilli për Zhvillim Rural në bashkëpunim me autoritetet lokale të planifikojnë zhvillimin e ardhshëm bujqësoro-rural dhe të ndërtojnë projekte e strategji zhvillimi;

- Përmirësimi dhe manaxhimi më i mirë i pasurive të bashkësisë në zonat rurale. Përdorimi i tyre në mënyrë të qëndrueshme për sot dhe brezat e ardhshëm.
- Zhvillimi dhe përfshirja e aftësive kryesore sidomos në fusha inovative/të reja nga të rinjtë për të ndërtuar komunitete rurale cilësore.

Duke patur parasysh se komunitetet përballen me shumë sfida dhe në të njëjtën kohë kanë potencial të kapërcejnë ato vështirësi sidomos duke pasur kushtet, mundësitë dhe mbështetjen e duhur, ne bëjmë thirrje për:

- Njohje të kapacitetit të komuniteteve dhe zhvillimit në vazhdim të kulturës së mbështetjes dhe besimit në aktivitetet e drejtuara nga komuniteti;
- Një metodë gjithëpërfshirëse dhe proaktive në ndikimin dhe planifikimin pozitiv të komunitetit, të drejtuar nga banorët lokalë, që çon në vendim-marrje nëpërmjet sektorit bujqësor;
- Sektori rural duhet të jetë një pjesë e zhvillimit integral të shoqërisë, që kontribuon për mirëqenien e komuniteteve rurale dhe urbane duke përdorur plotësisht potencialin e vet produktiv;
- Duhet të përcaktohen politikat dhe strategjitë bazuar në bashkë-përgjegjësi dhe pjesëmarrje të përbashkët të të gjithë komponentëve të shoqërisë të vënë në praktikë;
- Njerëzit duhet të jenë protagonistë dhe përfitimet e tyre duhet të jenë objektivi kryesor i zhvillimit. Progresi i popullsisë që jeton në zonat përreth duhet të jetë prioriteti kryesor i një zhvillimi të tillë;
- Është e rëndësishme dhe urgjente promovimi i organizatave të pavarura duke përfshirë të rinjtë, gratë, burrat... të gjithë shoqërinë) duke u mundësuar njerëzve të luajnë një rol efektiv si protagonistë në aktivitetet e zhvillimit dhe të veprojnë si zëdhënës legjitimë përpara shoqërisë, qeverisë dhe industrisë;

Duke marrë parasysh se cilësia e lartë e jetesës dhe qëndrueshmëria e komuniteteve rurale varen nga menaxhimi pozitiv dhe mbrojtja e biodiversitetit, eko-sistemeve dhe bukurive natyrore, ne bëjmë thirrje për:

- Kontrollin dhe lehtësimin e rreziqeve të natyrës. Evitimi i këtyre rreziqeve me anë të teknikave përshtatëse të menaxhimit të tokës;
- Mbështetje për komunitetet që kërkojnë të lehtësojnë jetesën duke pakësuar karbonin në zonat e tyre;
- Planifikimi i zhvillimit rural i cili duhet të përshtatet sipas karakteristikave brenda kuadrit të një përdorimi integral dhe të qëndrueshëm;
- Përshtatja e masave specifike kombëtare dhe ndërkombëtare nevojitet me qëllim uljen e nivelit të ndotjes industriale që gjeneron ndotje të dëmshme atmosferike për pyjet dhe jetën e njerëzve, sidomos në rajonet e industrializuara;
- Zbatimi i ruajtjes dhe nxitjes së biodiversitetit;

Duke marrë në konsideratë se ekosistemi po rrezikohet nga degradimi, zhdukja e specieve (bimë dhe kafshë), varfërimi dhe përdorimi pa kritere i tokës, ndryshime të dëmshme

ekologjike, hidrologjike dhe klimatike, është e nevojshme të aplikohen zgjidhje të zgjuara, të arsyeshme për zhvillimin rural, ne bëjmë thirrje që:

- Të ndërtohen lidhje funksionale të këshillimit/ekstensionit, kërkimit, kreditimit, dhe furnitorëve të inpueteve të fermës në dhënien e shërbimeve si palca e suksesit të nxitjes eficiente të programeve të edukimit të fermerëve;
- Të përhapet informacioni bujqësor dhe përvoja/eksperienca, përfshi bashkëpunimin në përgatitjen, zbatimin e programeve fushore duke përmirësuar dhënien e shërbimeve të fermës dhe shmangien e mbivendosjeve, apo kundërshtitë/konfliktet gjatë këshillimit të fermerëve;
- Të zhvillohet “Planifikimi i Udhëhequr nga Komuniteti”;
Ky lloj planifikimi është një process i strukturuar në mënyrë të tillë që të përfshijë banorët e zonave rurale në diskutime dhe debate për zhvillimin e zonave ku jetojnë. Ky diskutim dhe debat do të inkurajojë komunitetet lokale rurale për të identifikuar prioritetet e zhvillimit lokal dhe të zhvillojnë zgjidhje lokale që kanë influence tek vendimmarrësit lokalë.
- Këshillimi për fermerin, duhet të kapë fermerët në gjendjen e tyre të vecantë, dmth **stadin e tanishëm të përvojës së tyre**, si dhe **nivelin e tanishëm të interesit dhe të kuptuarit**. Bile në të njëtin fshat, fermerët kanë grupet e përparësive sipas nevojave dhe interesave të tyre, dhe prandaj ata kanë idete e tyre për mënyrat dhe mjetet si ti përmbushin ato (nevojat dhe interesat).
- “Bujqësi e qëndrueshme” është bujqësia, e cila, nga ana ekonomike dhe sociale, është e aftë të mbijetojë dhe që për një periudhë të gjatë nuk e degradon mjedisin. Koncepti i bujqësisë së qëndrueshme është i bazuar në parimin e shumëfunktionalitetit, duke nënkuptuar se bujqësia, krahas produkteve fitimprurëse (ekonomike), prodhon edhe të mira publike, që lidhen me mjedisin, sigurimin e ushqimit, sigurinë ushqimore dhe konvergjencën rajonale dhe sociale. Këto funksione të jashtme të bujqësisë nuk drejtohen drejtpërdrejt tek tregjet dhe për këtë arsye, duhen mbështetur me masa gjithëpërfshirëse të politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural.
- Të përshtatet një koncept i ri i bujqësisë, i ashtuquajtur “Bujqësia 4.0”. Në të vërtetë, në kushtet kur bujqësia duhet të përmbushë kërkesat e së ardhmes: demografia, pakësimi i burimeve natyrore, ndryshimi klimatik dhe mbetjet ushqimore, zgjidhja është të përshtatet metoda e Bujqësisë 4.0, pra duke u fokusuar në bujqësinë preçize, lidhjen dhe aftësitë dixhitale si dhe përdorimin e të dhënave të rëndësishme drejt efikasiteteve të biznesit duke mbështetur fermerët të përdorin sasi minimale uji, pesticidesh, herbicide, plehëra kimike dhe duke targetuar shumë zona specifike. Teknologji të reja do ta mbështesin atë me përdorimin e pajisjeve, dronëve, sensorë për temperaturën dhe lagështirën, imazhe nga ajri, teknologji me GPS, etj.

Kështu që bujqësia do të jetë më fitimprurëse, efikase, e sigurt, dhe e përshtatur me mjedisin, duke e bërë më të sigurt dhe të mirë-paguar jetën dhe punën në bujqësisë.

Ky manifest u përgatit në kuadër të projektit “Rural Korçë”, financuar nga Bashkimi Europian dhe zbatuar nga Agjensia Rajonale e Zhvillimit Korçë dhe organizata jofitimprurëse Tamat Centro Studi Formazione e Ricerca (Itali).

Informacioni dhe pikëpamjet e shfaqura në këtë manifest janë të autorit (autorëve) dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht opinionin zyrtar të Bashkimit Europian. Institucionet e Bashkimit Europian dhe organet e tij apo personat që punojnë në emër të tij nuk janë përgjegjës për përdorimin e informacionit të pasqyruar këtu.

Autorizohet riprodhimi nëse citohet burimi.
